



## Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

594/20

Data/Datum.

30.09.20

PRISHTINË - ПРИШТИНА

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.594/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Beni Com” sh.p.k-Obiliq, “Linda” sh.p.k-Ferizaj, “Euro Infrastruktura”-Hani Elezit, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Rexha” SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK- Prishtinë”, më datën: 25.09.2020, mori këtë:

### V E N D I M

**I. APROVOHEN**, pjesërisht si e bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Beni Com” sh.p.k-Obiliq, “Linda” sh.p.k-Ferizaj, “Euro Infrastruktura”-Hani Elezit, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK- Prishtinë”.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK- Prishtinë”.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: “Beni Com” sh.p.k-Obiliq, “Linda” sh.p.k-Ferizaj, “Euro Infrastruktura” - Hani Elezit, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues “Beni Com” sh.p.k-Obiliq, “Linda” sh.p.k-Ferizaj, “Euro Infrastruktura” - Hani Elezit, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 24.08.2020 me nr. 594/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Rexha” SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK- Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 52, 59, 60, si dhe nenin 72 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 07.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Beni Com” SH.P.K- Obiliq & “Linda” SH.P.K- Ferizaj  
**Sqarim hyrës:** Komuna e Prishtinës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit të ofertave. Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK- Komuna e Prishtinës, mbase pas afateve të parapara me LPP. AK, përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

**Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP):** Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se kemi të bëjmë me ankese të përsëritur ku palët e përfshira në procedurë janë të njëjta, rrjedhimisht disa nga pretendimet ankimore tani veç i kemi trajtuar. Po ashtu edhe paneli shqyrtues i ka gjykuar me vendimin e datës 15.06.2020, me nr. 274/20. Përkatësisht pretendimi ankimore kundrejt kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional që lidhen me projektet e realizuara dhe konfliktin e interesit kundrejt stafit të prezantuar, paneli shqyrtues ka konstatuar.

Lidhur me projektet e realizuara përmes vendimit të lartë përmendur është konstatuar se: “...Obligohet AK që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga OE ankues lidhur me natyrën e punëve të cilat i ka dëshmuar përmes referencave, duke pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Pas sqarimit të këtyre kontratave dhe



referencave për natyrën e punëve të kryera nga OE ankues e për të cilat ka bashkangjitur këto referenca, AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së...” Eksperti shqyrtues sqaron se nuk ka hasur në ndonjë dëshmi të AK-së se ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me këtë pretendim. Andaj, ky pretendim është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër kundrejt konfliktit të interesit po ashtu paneli shqyrtues përmes të njëjtit vendim ka konstatuar: “...Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur me inxhinierët Safet Lipovica dhe Naser Surdulli, ky pretendim është i bazuar sepse në vendimin e AK-së të datës 07.02.2020 ku janë bashkangjitur dokumentet e hartimit të projektit, më saktë tek shtojca me emrin “vendimi i projektuesit” shihet se Safet Lipovica dhe Naser Surdulli, kanë punuar në të njëjtin projekt. Konkretisht Safet Lipovica në cilësinë e inxhinierit të arkitekturës. Të dy inxhinierët Safet Lipovica dhe Naser Surdulli, kanë punuar në hartimin e projektit në fjalë që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit me numër 616-18-094-2-2-1. Kurse, në realizim të projektit apo si fazë e dytë, është ky aktivitet i prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”, me nr. të prokurimit:616-19-7632-5-1-1.”.

Eksperti shqyrtues të njëjtin pretendim e sqaron edhe njëherë në mënyrë edhe me të zgjeruar ku Inxhinieri i operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe ai i parashtruesit të ankesës kane qen pjesë e stafit të projektit ideore. Tani inxhinieri i operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ekziston si staf i të njëjtit OE, rrjedhimisht nuk është i deklaruar në listë të pagave të ATK-se që nga muaji Maj i vitit 2018. Përderisa inxhinieri i parashtruesit të ankesës është pjesë e listës pagave të ATK-se, por nuk është i prezantuar në listë të stafit për këtë aktivitet të prokurimit.

Prove bashkangjitur me raport, gjeni listën e stafit të OE ankues të prezantuar në oferte, dhe listën e punëtorëve të lëshuar nga ATK, për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Megjithatë AK, përmes ri vlerësimit të ofertave, në arsyetimit të eliminimit lidhur me konfliktin e interesit kundrejt OE ankues e ka bazuar edhe në opinionin e Agjensionit Kundër Korrupsion me nr. AKK-DPKPP/03-03-845/20, të datës 10.06.2020. Provë bashkangjitur gjeni raportin e AKK-se Nr. AKK-DPKPP/03-03-845/20, te datës 10.06.2020 Lidhur me pretendimi tjetër ankimore që ka të bëjë se AK, nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit rrjedhimisht ka proceduar tutje duke bërë publikimin e njoftimi për dhëni të kontratës.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas shkresave të lendes rezulton që OE ankues kërkesën për ri shqyrtim e ka parashtruar me datën 15.08.2020, përderisa njoftimin për pezullim të aktivitetit të prokurimit e ka nxjerre me datën 26.08.2020. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron se dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar (shih par 2 të nenit 108/A të LPP-së).

Eksperti shqyrtues sqaron si përfundim se vlerësimi ynë është se AK, përgjatë ri vlerësimit të ofertave nuk i ka respektuar në tërësi rekomandimet e vendimit paraprak të PSH-se, nr. 274/20 përkatësisht nuk i ka trajtuar

në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik lidhur me konfliktin e interesit si dhe nuk ka kërkuar sqarime shtese lidhur me projektet e prezantuara nga operatori ekonomik ankues.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport propozimi ynë është që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, propozimi i AK-se, për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 07.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 07.09.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.09.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me kërkesë e dosjes së tenderit se OE ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 800.000,00 euro dhe nëse tenderuesi është grup i OE, lideri i grupit duhet të plotësoj 60% të vlerës së referencave. Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë pretendim ankimor është vendosur nga Paneli Shqyrtues në vendimin 274/20 i datës 15.06.2020 që me rastin e rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë për të sqaruar natyrën e punëve të referencave dhe kontratave. Pra, në vendimin e OSHP-së PSH.nr.274/20 të datë 15.06.2020 është konstatuar: “Andaj, obligohet AK që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga OE ankues lidhur me natyrën e punëve të cilat i ka dëshmuar përmes referencave, duke pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Pas sqarimit të këtyre kontratave dhe referencave për natyrën e punëve të kryera nga OE ankues e për të cilat ka bashkangjitur këto referenca, AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim



me nenin 59 të LPP-së.”.

Pra, duke pasur parasysh pretendimin e OE ankues dhe vendimin e OSHP-së për këtë pretendim, ku përmes vendimit të OSHP-së ishte obliguar AK që të kërkonte sqarime shtesë, eksperti shqyrtues sqaron se nuk ka hasur në ndonjë dëshmi të AK-së se ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me këtë pretendim. Andaj, ky pretendim është i bazuar.

Sa përket pretendimit ankimor që ka të bëjë me konfliktin e interesit, ku AK në Letër standarde për [tenderuesin] e eliminuar, operatorin ekonomik ankues e ka eliminuar me arsyetimin se në bazë të nenit 65 të LPP-së AK ka konstatuar se hartuesi i një pjese të projektit-statikës, z. Safet Lipovica është punonjës i OE “BENI COM” që dëshmohet në pasqyrat e trustit të dorëzuara nga vet OE.

Paneli Shqyrtues sqaron se në “Letër standarde për [tenderuesin] e eliminuar” dhe “Opinionit” të Agjencisë Kundër Korrupsionit me numër të referencës Nr. AKK-DPKPP/03-03-845/20, Agjencia Kundër Korrupsionit me datë 10.06.2020 ka nxjerr “Opinion”, ku ka konstatuar se ekziston konflikti i interesit në rastin e trajtuar me Nr.AKK-DPKPP/03-03-845/20 në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës”. Paneli Shqyrtues sqaron se Agjencia Kundër Korrupsionit ka konstatuar se paraqitet konflikti i interesit për faktin se Safet Lipovica punëtor i OE “Beni Com” Sh.p.k. ka marrë pjesë në hartimin e specifikave teknike, respektivisht në hartimin e dokumentacionit investivo-teknik për projektin “Renovimi i hapësirës tek posta-Lagja Dardani”. Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh opinionin e AKK-së, ku ka konstatuar se OE ankues gjendet në konflikt interesi, rrjedh se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se vendimi paraprak i OSHP-së qartë ka konstatuar se nuk ekziston konflikti i interesit dhe situata është e njëjtë edhe me operatorin ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës. Ku, OE ankues shton se në këtë rekomandim qartë vërehet diskriminimi ndaj neve si operator ekonomik dhe favorizimi i operatorit ekonomik “Rexha” SH.P.K, ku OE ankues ka cituar vendimin e OSHP-së nr. 274/20 të datës 15.06.2020.

Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur me konstatimin e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues në vendimin paraprak 274/20 se nuk ka konflikt interesi është i saktë. Mirëpo, duke pasur parasysh që pas ekspertizës së ekspertit shqyrtues dhe vendimit të Panelit Shqyrtues PSH.nr.274/20 është nxjerr opinionin nga Agjencia Kundër Korrupsionit në të cilin opinion konstatohet se ka konflikt interesi, atëherë kemi ndryshim të gjendjes pasi që Agjencia Kundër Korrupsionit është kompetente për të konstatuar se kur ekziston konflikti i interesit në bazë të ligjit për konfliktin e interesit.

Sa i përket pretendimit se OE ankues është diskriminuar lidhur me punëtorin Safet Lipovica kurse OE i

rekomanduar është favorizuar me punëtorin Naser Surdulli dhe se nëse ka konflikt interesi për punëtorin Safet Lipovica (punëtor i OE ankues), ngjashëm është situata edhe me punëtorin Naser Surdulli (punëtor i OE të rekomanduar për kontratë) sepse që të dy kanë qenë hartues të këtij projekti.

Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të listës së pagave të OE ankues shihet që punëtori Safet Lipovica gjendet në listën e pagave deri në muajin e dhjetë (Tetor) të vitit 2019 (deri në momentin e nxjerrjes së listës së pagave nga ATK-ja), do të thotë se ishte punëtor kur është shpallur njoftimi për kontratë. Kurse, sa i përket pretendimit që ka të bëjë me favorizim të OE të rekomanduar për punëtorin Naser Surdulli, Paneli Shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të kontratave të punëtorëve dhe listës së pagave të nxjerr nga ATK-ja, rezulton se Naser Surdulli është në listën e pagave deri në muajin Maj të vitit 2018, konkretisht në bazë të listës së pagave i njëjti kishte më shumë se një vit e gjysmë që nuk ishte në listën e pagave nga koha kur janë dorëzuar ofertat. Pra, duke pasur parasysh që Naser Surdulli nuk është në listën e pagave nga muaji Qershor 2018 dhe kishte një periudhë kohore më shumë se një vit e gjysmë nga shpallja e njoftimit për kontratë, respektivisht kishte më shumë se gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i planifikimit të prokurimit atëherë rezulton se AK ka vepruar drejt.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe në bazë të shkresave të lëndës të cilat i ka pas në dispozicion sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar konform nenit 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se ka pasur parasysh edhe opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ku ka konstatuar se ekziston konflikti i interesit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 /AK/- "KK- Prishtinë",

1x1 / OE/ - "Beni Com" sh.p.k-Obiliq, "Linda" sh.p.k-Ferizaj, "Euro Infrastruktura"-Hani Elezit

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

